

**Maqedoni e Veriut: WoMen Lead**  
**Avancimi i Barazisë Gjinore përmes Pjesëmarrjes së Grave në Politikë**

**1 nëntor 1, 2020 – 30 korrik 30, 2023**

Avancimi i barazisë gjinore është sfidë thelbësore në progresin demokratik të Maqedonisë së Veriut. Gratë në Maqedoninë e Veriut kanë qasje të kufizuar në forcën vendimmarrëse sepse ballafaqohen me pengesa individuale, shoqëro-kulturore, dhe institucionale për pjesëmarrje politike. Pengesat për barazi gjinore në vendimmarrje përfshijnë mungesë të përvojës dhe aftësive tek politikanet femra, pengesa institucionale brenda partive politike, parlamentit dhe qeverisë, norma ngulmuese shoqërore e kulturore që pasqyrojnë paragjykimet gjinore, dhe dhunën ndaj grave në politikë (DHNG-P). Një mjedis më i favorshëm për pjesëmarrjen e grave në politikë do të kontribonte për barazinë gjinore në përgjithësi dhe do të rriste gjasat që më shumë gra të zgjedhin të jenë pjesë e jetës politike.

Financuar nga Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim dhe Bashkëpunim e Suedisë (Sida) dhe duke u mbështetur në ekspertizë globale dhe në ekspertizë me specifika lokale mbi pjesëmarrjen e grave në politikë, Instituti Nacional Demokratik (NDI) bën lansimin e WoMen Lead (#WoMenLead), program që fuqizon dhe ul pengesat individuale, shoqëro-kulturore, dhe institucionale për pjesëmarrjen e grave në politikë në Maqedoninë e Veriut. Përmes këtij programi, NDI ka për qëllim të rrisë barazinë gjinore nëpër parti politike, t'u ofrojë kandidatëve aftësi dhe mjedis inkurajues për fushatë të suksesshme dhe qeverisje në nivel lokal, dhe të ulë dhunën kundër grave në politikë.

**NDI do të zbatojë qasje në tri nivele për të rritur pjesëmarrjen e mirëfilltë dhe të sigurt të grave, dhe përfaqësimin e tyre në politikë.**

➤ E para, NDI do të angazhojë udhëheqje të partive politike përgjatë spektrit ideologjik. Në koordinim me udhëheqësinë partiake, NDI do të lansojë Grup Punues për Barazi Gjinore për të vlerësuar praktikat ekzistuese për barazi gjinore brenda partive politike, dhe do të ndërmarrë aktivitete për të promovuar pjesëmarrjen e grave në politikë dhe luftën kundër DHNG-P. Në konsultë me

Grupin Punues, NDI do të ofrojë trajnim për ndërtim të kapaciteteve për liderët dhe lideret që janë në zhvillim e sipër për të nxitur talentin brenda partive politike. Seancat e trajnimeve do të fokusohen në zhvillim të politikave inkluzive dhe aftësive udhëheqëse.

➤ E dyta, duke pasur parasysh që intervenimet që bëhen në nivel lokal janë investim për të ardhmen e angazhimit politik të grave në nivel nacional, NDI do t'u ofrojë ndihmë të targetuar teknike kandidatëve që do të garojnë për t'u zgjedhur në funksione në nivel komunal. NDI do të organizojë seanca trajnime për të ndërtuar aftësi dhe njohuri të nevojshme për të hartuar dhe për të zbatuar me sukses një fushatë zgjedhore, dhe do të krijojë rrjete për mbështetje mes kolegeve për

"Pra, dua ta them qartë: dhuna nuk është çmim i ligjshëm ose i pashmangshëm që gratë duhet ta pagojnë kur janë pjesë e politikës. Pjesëmarrja në politikë është mënyra për të ndaluar dhunën ndaj grave."

Medlin K. Olbrajt, Kryesuese e NDI dhe  
Sekretare e 64 Amerikane e Shtetit

t'iu mundësuar atyre të lidhen me njëra-tjetrën gjatë dhe pas ciklit zgjedhor. Gjithashtu, NDI do të ofrojë trajnime për barazi gjinore për kandidatët meshkuj që planifikojnë të garojnë për këshillat komunalë.

➤ E treta, NDI do të bashkëpunojë me partitë politike, parlamentin, shoqërinë civile, dhe me mediat për të rritur vetëdijen mbi DHNG-P dhe do të shqyrtojë masat për të ndaluar këtë pengesë të shërbimit publik. Në këtë drejtim, NDI do të lansojë fushatë mediatike për të vetëdijësuar opinionin politik dhe atë publik kundër gjuhës së urrejtjes dhe për të nxitur mbrojtje ligjore kundër DHNG-P. Poashtu, NDI do të bashkëpunojë me parti politike që marrin pjesë në zgjedhje lokale për të nënshkruar Kodin e Sjelljes si zotim për luftë kundër DHNG-P.

Për më shumë informata mbi WoMen Lead, ju lutemi kontaktoni Genevieve Shea ([gshea@ndi.org](mailto:gshea@ndi.org)) në Uashington D.C. ose Aleksandra Cvetkovska ([acvetkovska@ndi.org](mailto:acvetkovska@ndi.org)) në Maqedoninë e Veriut.